

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet apo mosveprimet e DPT (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave –Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjes)

Qytetarët dhe subjektet tatimpaguese kanë të drejtë të paraqesin kërkesa, ankesa ose shqetësime që lidhen me veprimet apo mosveprimet e Administratës Tatimore.

Përmes kësaj procedure, ju mund të:

- paraqisni ankesa për mënyrën e trajtimit nga Administrata Tatimore;
- kërkonti sqarime mbi procedura, vendimmarrje ose shërbime tatimore;
- raportoni problematika që hasni gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve tuaja tatimore.

Qëllimi i këtij procesi është trajtimi i çdo rasti në mënyrë transparente dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të Administratës Tatimore.

Procedura për paraqitjen e kërkesës ose ankesës

1. Me telefon (pa pagesë)

Ju mund të paraqisni kërkesën ose ankesën tuaj duke telefonuar në numrin: **0800 0002**

Orari i shërbimit: Hënë – Enjte: 08:00 – 16:30

E Premte: 08:00 – 14:00

Gjatë orarit zyrtar, një punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do t'ju përgjigjet. Jashtë orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit, mund të lini mesazh zanor me përshkrimin e shqetësimit tuaj.

2. Me postë elektronike (e-mail)

Kërkesat dhe ankesat mund të dërgohen në një nga adresat e mëposhtme të postës elektronike:

- zyraeshtypit@tatime.gov.al
- punainformale@tatime.gov.al
- denoncime@tatime.gov.al

Për t'iu drejtuar drejtorive rajonale, adresat përkatëse gjenden në linkun vijues:

- <https://www.tatime.gov.al/c/9/157/drejtorite-rajonale> në këtë link janë kontaktet e drejtorive rajonale

3. Me postë

Kërkesat dhe ankesat mund të dërgohen edhe në rrugë zyrtare postare në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Rruga “Gjin Bue Shpata” (mbrapa Stadiumit “Selman Stërmasi”) Kodi postar, 1001Tiranë

4. Dorazi

Dokumentacioni mund të dorëzohet fizikisht në zyrën e protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në adresën e sipërpërmendur.